



**KOLEGJI AAB – PRISHTINE**  
**FAKULTETI JURIDIK**  
**Dekanatit**

**Programi për Studimet: Master**

**Emri i programit të Masterit: Administratë Publike dhe Diplomaci**

**Lënda: Kërkesë për lejimin e punimit të diplomës**

**Kandidati: Florina Vula nga Gjakova**

**Titulli i Temës: Roli dhe Funkzioni i Administratës Publike në Kosovë**

**Propozimi për mentor: Prof. Ass. Dr. Dashnim Ismajli**

**Përshkrimi i shkurtër i temës:**

Termi administratë publike do të thotë “zbatimi i politikave të qeverisë dhe një disiplinë akademike që studion këtë zbatim dhe që përgatit nëpunësit civilë për punë”. Administrata publike është një strukturë organizative që paraqet bazën për vendimmarrje dhe zbatimin e vendimeve, rregulla sipas të cilave realizohen shërbimet publike.

Sa i përket Kosovës, Administrata publike ka një rol të rëndësishëm pasi që është një pjesë thelbësore e procesit të shtetndërtimit. Megjithatë, Republika e Kosovës si një shtet i ri nuk ka një administratë efikase dhe mjaft funksionale. Shteti është funksional dhe efikas vetëm me një administratë publike të zhvilluar, profesionale dhe të përgjegjshme. Prandaj edhe reforma administrative duhet të jetë në funksion të administratës publike, për të forcuar kapacitetet e saj dhe për ta bërë atë më efikase dhe më të përgjegjshme.

Punimi është një përpjekje modeste që të ofrojë një pasqyrë të përgjithshme mbi rolin dhe funksionet e administratës publike në nivel qendror dhe lokal, si strukturë dhe si numër, dhe të ofroj propozime konkrete për reformën e kësaj administrate si kriter kyç i BE-së për avancimin e Kosovës në rrugën e integritit evropian.

Punimi mendojmë se ka një rëndësi të madhe praktike në kontekstin e mjedisit kosovar, pasi jemi të vetëdijshëm se, në Kosovë si një shtet i ri, Administrata Publike ka nevojë që të avancoj rolin e saj publik dhe të jetë në funksion të qytetarëve, të jetë transparente dhe të funksionoj në bazë të parimit të ligjshmërisë kërkesa këto që do ti trajtojmë në këtë punim masteri duke ofruar edhe zgjidhje konkrete për avancimin e komizës ligjore, decentralizimit, thjeshtimin e procedurave, informatizimin e shërbimeve dhe përmirësimin e zhvillimeve në lëmin e burimeve njerëzore.

Prishtinë,  
Data, 03.05.2016

Nënshkrimi-i kandidatit